



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 6, datë 13.02.2021

“PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA GRANTI I RIKONSTRUKSIONIT”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar, vendimit nr. 57, datë 01.06.2020 të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit dhe miratimit të udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit”, urdhrin nr. 11408/1, datë 25.03.2020, të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga programi i grantit të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në vijim të Raportit nr. 7285 prot, datë 12.02.2021 të Komisionit të Posaçëm, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e raportit të komisionit të posaçëm për subjektet përfituese nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
2. Të miratojë sipas kategorive të dëmit DS1, DS2 dhe DS3, listën emërore të subjekteve përfituese nga granti i rikonstruksionit, sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Bashkia Tiranë ngarkohet të korrigjojë gabimet në rast se evidentohen në listën e përfituesve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe në aktet e tjera të Këshillit Bashkiak që kanë për objekt shpalljen e listave fituese nga grantet e rikonstruksionit. Korrigjimet i paraqiten këshillit bashkiak për miratim.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Tiranë.
5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe njoftohet publikisht.

K R Y E T A R I

ROMINA KUKO

